



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 9.7.2021, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Ekrem Mustafa, Arbëreshë Kryeziu- Hyseni, Salih Zyba, Bekim Haxhiu.

Munguan: Zoran Mojsilović, Albena Reshitaj, Fadil Nura, Besian Mustafa, Samra Ilijazi.

Pjesëmarrës të tjerë: Edolind Bytyçi, praktikant, Florent Mehmeti, Shqipe Shala dhe tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi, **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky :

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i dy procesverbaleve të kaluara nga mbledhjet 29 qershor dhe 2 korrik,**
- 3. Nisma ligjore për siguri në rrugë,**
- 4. Shqyrtimi i projektligjit për automjete ndryshim e plotësim i ligjit 05/L-132,**
- 5. Caktimi i ekspertëve dhe grupeve punuese për mbikëqyrjen e ligjeve,**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e dt. 29.6.2021 dhe 2.7.2021

Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e kaluara dt.29 qershor dhe 2 korrik.

3. Nisma ligjore për siguri në rrugë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës reagoi **Salih Zyba** dhe **Bekim Haxhiu** për mënyrën se si është renditur si pikë për mbledhje pa ndonjë material përkatës, ngase nuk ka pasur ndonjë diskutim në komision, ndërkaq **Kryetarja** pohoi këtë por njoftoi se kjo pikë sot është vetëm për diskutim ngase ekziston pëlqimi me Komisionin për siguri bashkërisht me këtë komision të inicohet nismë ligjore për siguri në trafikë duke kërkuar ndryshim të Ligjit për rregullat në trafik, sepse shqetësimi vjen nga numri i madhë i aksidenteve në rrug. **Sali Zyba** u interesua se çfarë bashkëpunimi duhet me komisionin për siguri, të mbështetet ai komision apo bashkërisht të bëhet iniciativa, ndërkaq **Kryetarja** sqaroi se Komisioni për siguri ka kërkuar takim me këtë komision, pastaj të vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme dmth në vijim do të organizohet një takim i përbashkët. **Bekim Haxhiu** tha se është për tu gëzuar kësaj nisme por duhet të shikohet mos po hyjmë në kompetencat e një komisioni tjetër, poashtu para vedi nuk kemi asnjë material për të diskutuar, ndaj sot nuk e ka vendin kjo pikë të diskutohet ngase duhet të shohim ky ligj apo nismë a prekë në fushën e sigurisë apo fushën e këtij komisioni, apo ne dëshirojmë të bëjmë një ligj e pastaj atyre me ju përcjellë dhe a është në agjendën e qeverisë. **Kryesuesja** përsëriti se sot asgjë nuk kërkohet për miratim por Komisioni për siguri ka kërkuar nga ky komision bashkëpunim ngase këtij komisioni i takon infrastruktura rrugorre, dmth kanë kërkuar bashkëpunim. Një herë për një herë është ligji aktual si dokument ekzistues. **Arbëreshë Kryeziu-Hyseni** gjithashtu arsyetoi në parim këtë nismë të duhur dhe angazhimin e këtij komisioni si kompetente me më shumë përgjegjësi se komisionet tjera, por bashkëpunimi është i mirseardhur. **Kryetarja** përmbylli këtë pikë dhe sugjeroi që pasi të organizohet një takim me komisionin përkatës për siguri, do të dalim me një qëndrim të caktuar për këtë nismë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete

Kryetarja fillimisht njoftoi se për këtë projekt ligj qka është ndërmarr si dhe sugjerimet dhe vërejtjet e dërguara, ajo propozoi që Komisioni mos të zhargit këtë projektligj pa nevojë dhe të votohet për mbledhje plenare për leximin e dytë, ndoshta me një amendament sepse stafi ka sugjeruar tri gabime teknike të përmirësohen. Sa i përket grupit punues të formuar, ajo potencoi se ky grup do të angazhohet për ligj të ri jo për këtë projektligj, pra shqyrtimet e mëtejme do të tregojnë se çfarë duhet të ndërmerren në përgjithësi me këtë ligj në fuqi dhe të propozohet qeverisë për ndonjë nismë të re apo ndonjë ligj të ri. Detyrimi për homologim shumë mirë është e sqaruar në memorandum shpjegues të këtij projektligji.

Bekim Haxhiu u interesua për shqyrtim të mëtejme të këtij projektligji ngase nga ZKM kemi shkresën zyrtare që të hiqet homologimi për automjete të reja por jo edhe për ato të papërdorura, gjithashtu potencoi se ka nevojë për një dëgjim publik me ekspertët, përndryshe nuk ka vend në këtë Projektligj pika 1.14 sepse i jepet monopoli një ministri të veproj sipas dëshirës me një ligj për një nen me ndryshua, duke shtuar apo duke hequr shtetet përkatëse.

Salih Zyba sqaroi se Projektligji është hartuar për ta liruar prej një bare qytetarin dhe është një nen tjetër që përkufizon vjetërsimin e automjeteve, dmth po flasim pr automjetet që dëshmohet gjendja e rregullsisë së tyre, kurse vjetërsia është maksimum 10 vjet, ndërsa vendet janë ato që përdorin standarde të njejta si në Kosovë, ndaj pse të kemi dyshime, nuk e di, tha. Për vërejtjet që thuhet sot dhe vërejtjet e dërguara nga kompanitë , ato i përkasinë ligjit në fuqi për automjete, që i bjen se me këtë projektligj jemi vonë dhe duhet ta dërgojmë në miratim. Shqetësimet e z. Haxhiu janë afatgjate dhe pajtohem por argumente për dyshim për këtë projektligj nuk ka sepse përkufizimi i vendeve është bërë sepse kanë standard të njejtë me Kosovën.

Pasi që **Kryetarja** e hodhi në votim dërgimin e Projektligjit për leximin e dytë, **Bekim Haxhiu** lëshoi mbledhjen pasi nuk u pajtua që ky PL të shkoi pa dëgjim publik si praktikë parlamentare, ndaj **Kryetarja** përfundoi mbledhjen për shkak të mungesës së kuorumit.

Mbledhja përfundoi në orën 9:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Fitore Pacolli-Dalipi